



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

**THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME NË ART, KULTURË, TRASHËGIMI
KULTURORE DHE SPORT PËR VITIN 2025**

Bashkia Durrës, e angazhuar për promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë dhe sportit, si dhe e udhëhequr nga vizioni për ta shndërruar qytetin në një qendër të rëndësishme kulturore, turistike dhe sportive, shpall Thirrjen për Projekte për vitin 2025. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, kjo iniciativë synon të krijojë një mjedis frymëzues dhe mbështetës për komunitetin artistik, kulturor dhe sportiv. Qëllimi është gjallërimi i jetës kulturore dhe sportive të qytetit, si dhe nxitja e zhvillimit ekonomik vendor, duke kontribuar në pasurimin e identitetit dhe dinamizmit të Durrësit.

Qëllimi dhe Prioritetet:

Thirrja synon të mbështesë:

- Krijimtarinë artistike kulturore
- Aktivitete kulturore dhe artistike që përcjellin vlerat dhe traditat e trashëgimisë kulturore.
- Projekte që ndërthurin artin dhe trashëgimninë Kulturore
- Projekte sportive, që promovojnë aktivitetin fizik, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e jetës sportive në komunitet.

Kush mund të aplikojë?

Thirrja është e hapur për:

- Persona juridikë të regjistruar si OJF.
- Individë dhe persona fizikë të regjistruar në QKB, të cilët kanë si objekt promovimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e artit, kulturës, trashëgimisë kulturore dhe sportit.

Afati i Aplikimit:

Thirrja do të qëndrojë e hapur **deri më 25 shkurt 2025**. Periudha e realizimit të projekteve do të jetë nga mars deri dhjetor 2025.

Mënyra e Aplikimit:

Projekt-propozimet tuaja duhet të adresohen pranë **Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komunitetit Fetar**, në Bashkinë Durrës.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur tek **Zyra e Informacionit** të Bashkisë Durrës.

Elektronikisht në adresën info@durres.gov.al

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Drejtorinë e Arsim Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë Durrës.

Le të bashkojmë forcat për një Durrës më të gjallëruar, kreativ dhe të fuqishëm, duke respektuar traditën dhe përqaftuar inovacionin !